DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-614/5
Data Datum Date 28.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Për:	**Ramiz Lladrovci** , Kryetar i Komunës së Gllogocit , **Burim Bujupi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës Gllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	**Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së **Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	**Erblin Hetemi**, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë:19.10.2026 -VI-020-614
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	**Xhevat Tafa,** Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit **Diturie Bekteshi,** Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi 02Nr.400/01-41148 për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 25.09.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.09.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me legjislacionin në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Vendimi 02Nr.400/01-41148 për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, është bazuar në nenet 11,12, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, në nenin 18 të Ligjit Nr.06/l-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e mbajtur të datës 25.09.2026 i miratuar me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA I REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA I GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-614/5
Data. Datum. Date. 28.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Za:	**Ramiz Lladrovci**, gradonačelnik opštine Glogovac **Burim Bujupi**, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administarciju dokumenata u opštini	
Preko:	**Elbert Krasniqi**, ministar MALS-a, **Jeton Qela**, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	**Erblin Hetemi**, direktor Pravnog odeljenja /MALS	Dana.19.10.2026 VI-020-614
Odgovorni službenici: 1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene: 2.Službenik/ca za izradu pravne procene	**Xhevat Tafa**, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika **Diturie Bekteshi**, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata	
Predmet:	Potvrda zakonitosti	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i Uredbe (VRK) br. 03/2026 o postupku adminisrativnog razmatranja opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je prihvatilo na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći opštinski akt:

Odluka 02br.400/01-41148 o formiranju komisije za žalbe koja će razmatrati žalbe stranaka u postupku za davanje na dugoročno i kratkoročno korišćenje nepokretne imovine opštine
Usvojena dana, 25.09.2026.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 28.09.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u saglasnosti sa zakonodavstvom na snazi i kao takav može proizvesti pravne efekte .

OBRAZLOŽENJE

Odluka 02 br. 400/01-41148 o formiranju komisije za žalbe koja će razmatrati žalbe stranaka u postupku za dodelu kratkoročnog i dugoročnog korišćenja nepokretne imovine opštine.

MALS, konstatuje da je akt koji je usvojila Skupština opštine Glogovac zasnovan na članovima 11, 12, 40 Zakona o lokalnoj samoupravi, članu 34 Statuta opštine Glogovac, članu 18 Zakona br. 06/l-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine i članu 18 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine.

Odluka je usvojena na sednici održanoj dana, 25.09.2026. godine, sa 21 glasom "za", 0 "protiv" i 0 "uzdržanih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data. Datum. Date. 28.09.2026
Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Viera
-VL- | 020- | 614

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
02 Nr. 400/01-4448 dt. 28/09/2026

Bazuar në nenin 11, 12, 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e të rregullt të mbajtur më 25.09.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

Neni 1

Më këtë Vendim miratoi Kuvendi i Komunës formimin e komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si vijon:

1. Besart Bajrami - anëtar nga ekzekutivi,
2. Vlora Zuqaku - Morina - anëtare nga ekzekutivi,
3. Erblinë Morina - anëtare nga kuvendi,
4. Egzona Tërdevci - anëtare nga kuvendi dhe
5. Mehdi Ademi - anëtar nga sektori jo qeveritar.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit të Ankesave është: të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, duke u bazuar në Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3

Pala e pa kënaqur nga procesi i vlerësimit final të ofertave nga Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës , ka të drejtë të paraqes ankesë brenda shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e Ankesave, i cili shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies se pronës se paluajtshme në shfrytëzim.

Neni 4

Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

A r s y e t i m i

Komuna e Drenasit, respektivisht ekzekutivi i saj duke u bazuar ne ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Drenasit formimin e komisionit të ankesave, i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

E gjithë kjo kur kemi parasysh vendimin nr.02-462/01-7729, të datës 27.02.2026 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë, Konfirmimin e ligjshmërisë Nr.020-165/9 i datës 24.03.2026 i vendimit 02-462/01-7729 të datës 27.02.2026, si dhe vendimin Nr.01-400/01-40216, të datës 21.09.2026 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Me respekt!